

# Mjetet dhe procedurat terapeutike dhe agjërimi

﴿ مفطرات الصيام المعاصرة ﴾

[ Shqip – Albanian – ألباني ]

Naji b. Hamed El Hamed

**Përktheu:** Driton Lekaj

**Redaktoi :** Redaksia e revistës ‘Albislam’

2009 - 1430

islamhouse.com

# ﴿ مفطرات الصيام المعاصرة ﴾

[ شqip – Albanian – ألباني ]

نايف بن أحمد الحمد

ترجمة: دريتون ليكاي

مراجعة: هيئة تحرير مجلة 'Albislam'

2009 - 1430

islamhouse.com

## Mjetet dhe procedurat terapeutike dhe agjërimi

Falënderimi i takon Allahut dhe mëshira e bekimi qofshin për atë që nuk ka pejgamber pas tij:

E kam shikuar librin "**Gjërat bashkëkohore që e prishin agjërimin**" të Dr. Ahmed b. Muhamed el-Halil - Allahu e ruajt - dhe e kam parë si një libër të dobishëm, ku ka mbledhur disa çështje mjekësore bashkëkohore, të cilat nuk dihen se e prishin agjërimin apo jo. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre çështjeve dhe pyetjeve të shumta rreth tyre, i kam përmbledhur ato dhe i kam shtuar pak gjëra me shpresë që Allahu t'iu bën dobi të gjithëve.

E këto çështje janë:

**1. Inhalatori për astmë:** Dy dijetarët e shquar Ibën Bazi dhe Uthejmini - Allahu i mëshiroftë - si dhe komisioni i përhershëm për Fetva ndajnë mendimin se ai nuk e prishë agjërimin ngase, inhalatori avullohet dhe nuk arrin deri në stomak, por arrin deri te kanali i frymëmarrjes (laringu). Atë e krahasojnë me shpëlarjen e gojës (gjatë abdesit) dhe sivakun (pastrimin e dhëmbëve me misvak).

**2. Tabletat që vendosen nën gjuhë për mjekimin e disa sëmundjeve të zemrës,** të cilat nuk hynë në brendësi të trupit, atëherë këto tableta nuk e prishin agjërimin.

**3. Endoskopi<sup>1</sup> për stomakun:** Shumica e dijetarëve ndajnë mendimin se ai që fut diçka në brendësi të trupit e prish agjërimin

---

<sup>1</sup> Instrument që shërben për të shikuar në zgavrat e trupit

edhe nëse nuk është ushqyes. Ibën Abbasi ka thënë: "Agjërimi prishet nga gjërat që hyjnë e jo nga ato që dalin".<sup>2</sup>

Disa dijetarë të medhhebit Malikij dhe Ibën Tejmijje kanë mendimin se nuk e prish agjërimin ajo që hyn në stomak, nëse nuk është pije apo ushqim. Hoxha ynë, Ibën Uthejmini – Allahu e mëshiroftë - e ka zgjedhur mendimin se endoskopi nuk e prish agjërimin përveç nëse vendoset me endoskop një materie e yndyrshme që është ushqyese dhe e cila e lehtëson hyrjen e endoskopit në të. Me këtë rast agjërimin e prish kjo materie e jo futja e endoskopit, ngase nuk prish agjërimin ajo që nuk është ushqyese.

Gjithashtu, ky është edhe medhhebi i Hanefinjve të cilët kushtëzuan që ajo e cila hyn në brendi të trupit, të mbetet në të e tëra, duke mos mbetur jashtë diç prej saj. Pra, endoskopi nuk mbetet në brendi të trupit i tëri, madje dhe një pjesë e tij mbetet jashtë.

**4. Pikat e hundës:** Dy dijetarët e shquar, Ibën Bazi dhe Uthejmini - Allahu i mëshiroftë – kanë mendimin se ato nuk e prishin agjërimin por, Ibën Bazi e kushtëzon prishjen e agjërimit: nëse e ndien shijen e saj në fyt, ndërsa Uthejmini e kushtëzon që ato të arrijnë deri në stomak, për shkak të hadithit të transmetuar nga Lekit b. Sabireh: "...dhe shpërlaje hundën mirë (istinshak) përveç, nëse je agjërueshëm".<sup>3</sup> Ndërsa, dijetarë të tjerë bashkëkohorë konsiderojnë që ato nuk prishin agjërimin, ngase nuk janë ushqime apo pije e as diçka të ngjashme me to dhe kjo çka arrin është shumë më pak sesa uji që mbetet nga shpëlarja e gojës (gjatë abdesit).

---

<sup>2</sup> Transmeton Bejhekiu 4/261, e Neveviu dhe Ibën Haxheri e kanë konsideruar hasen

<sup>3</sup> Transmeton Ebu Davudi (142) dhe Nesaiu (87) e Ibn Hibbani e konsideron të vërtetë.

**5. Gazi i oksigjenit:** nuk e prish agjërimin, ngase nuk është ushqim, pije apo diç e ngjashme me to.

**6. Inhalatori i hundës:** ka normë të ngjashme me inhalatorin për astmë.

**7. Anestezioni:** i cili është disa llojesh:

- Anestezioni nëpërmjet hundës me një materie nga gazi nuk e prish agjërimin, ngase materia e gaztë nuk është trupth.

- Anestezioni kinez (me gjilpëra) nuk e prish agjërimin për shkak të mos hyrjes së asnjë gjëje në brendi të trupit.

- Anestezioni me injeksione: nëse është anestezion lokal nuk e prish agjërimin, për shkak të mos hyrjes së asnjë gjëje në brendi të trupit.

- **Anestezioni i tërësishëm, dhe këtu janë dy çështje:**

**E para:** Humbja e vetëdijes:

- Nëse e humbë vetëdijen gjatë gjithë ditës, shumica e dijetarëve të medhhebit Malikijj, Shafij dhe Hanbelijj kanë mendimin se agjërimi i tij prishet për shkak të hadithit të transmetuar nga Ebu Hurejre: "...e len ushqimin, pijen dhe kënaqësitë (seksuale) e tij"<sup>4</sup>, e abstenimi i përmendur në këtë hadith i takon agjëruetit, ndërsa ai që humbë vetëdijen nuk mund të quhet agjëruet.

- Nëse humbja e vetëdijes nuk zgjatë tërë ditën, Imam Maliku thotë që agjërimi i tij prishet, ndërsa Shafiu dhe Ahmedi thonë se nuk prishet dhe kjo është më afër të vërtetës, ngase nuk ka argument për prishjen e agjërimin të tij.

**E Dyta:** Nëse shoqërohet anestezioni me një materie ushqyese atëherë, prishet agjërimi edhe nëse humbja e vetëdijes nuk zgjatë tërë ditën.

---

<sup>4</sup> Transmeton Buhariu (1795)

**8. Pikat e veshit:** nëse nuk gjendet ndonjë e çarë në timpan apo nuk arrin diç në fyt agjërimi është i saktë por, nëse e ndien shijen e saj atëherë, prishet agjërimi te shumica e dijetarëve.

**9. Losioni i veshit (lëng për pastrim):** Ai zakonisht përmban sasi të mëdha të ujit, e nëse timpani është i çarë dhe arrin diç në fyt agjërimi i prishet, sipas shumicës së dijetarëve por, nëse nuk arrin asgjë në fyt, nuk prishet.

**10. Pikat e syrit:** Dy dijetarët e shquar Ibën Bazi dhe Uthejmini – Allahu i mëshiroftë - e kanë zgjedhur mendimin se pikat e syrit nuk e prishin agjërimin ngase, sytë nuk janë rrugë të ushqimit dhe pijes. Të njëjtin mendim e kanë Hanefinjët dhe Shafinjët për kuhlën (bojë për qepalla)

**11. Injeksioni nën lëkuror apo muskolor:** nuk e prishin agjërimin, ngase nuk është ushqim, pije apo diç ngjashëm me to e ky është mendimi i zgjedhur nga dy dijetarët e shquar Ibën Bazi dhe Uthejmini – Allahu i mëshiroftë.

**12. Injeksioni ushqyes (vitaminoz) në vena:** konsiderohet nga gjërat që e prishin agjërimin, ngase është i ngjashëm me ushqimin dhe pijen.

**13. Kremat dhe fashat ngjitëse:** nuk e prishin agjërimin, ngase nuk janë në kuptim të ushqimit dhe pijes.

**14. Endoskopi i barkut:** i cili futet nëpërmjet një vrime të vogël nga sipërfaqja e barkut për ta eliminuar mëshikëzën e tëmthit në mënyrë endoskopike (kolecistektomi) apo diagnostifikimit të disa sëmundjeve. Kjo çështje krahasohet me xhaife-n, e cila është plagë në bark që arrin deri në brendi të trupit. Dijetarët e medhhebit Malikij thonë se nuk e prish agjërimin, e këtë e ka zgjedhur edhe Shejhul-Islam Ibën Tejmije, ngase myslimanët plagoseshin gjatë xihadit dhe sikur nga plagët e tilla do të prishej agjërimi, do t'u sqarohej atyre.

**15. Dializa<sup>5</sup>:** Hoxha ynë, dijetari i shquar Ibën Bazi e ka zgjedhur mendimin se kjo e prish agjërimin, ngase dializa e furnizon trupin me gjak të pastër sikur edhe ndoshta e furnizon me materie ushqyese, kështu që bashkohen dy prishës të agjërimin.

**16. Losioni vaginal, hapat anal (supozitorët) dhe endoskopi vaginal:** Malikinjtë dhe Hanbelinjët thonë: Nëse gruaja përdor pika në vaginën e saj, nuk i prishet agjërimi me këtë.

**17. Klizma:** Shumica e dijetarëve nga katër medhhebet thonë se nga klizma prishet agjërimi, ngase arrin deri në brendi të trupit por, Ibën Tejmijje e ka zgjedhur mendimin, i cili është edhe medhhebi i Dhahirive: se ajo nuk e prish agjërimin ngase, nuk ushqen, por nxjerr atë çka është në trup, njëlloj si purgativet që merren nëpërmjet nuhatjes. E këtë e ka zgjedhur edhe dijetari i shquar Ibën Uthejmini – Allahu e mëshiroftë, nëse lënda e saj është ilaç e jo ushqyese.

**18. Supozitorët:** Dijetari i shquar Ibën Uthejmini e ka zgjedhur mendimin se nuk e prish agjërimin, ngase përmban materie ilaçi e nuk ka në të diç të lëngët dhe nuk është ushqim, pije apo diç e ngjashme me to.

**19. Dhënia i gjakut:** Krahasohet me hixhamen, e ata që thonë se hixhameja e prish agjërimin, të njëjtën e thotë edhe për dhënien e gjakut, dhe e kundërta. Dy dijetarët e shquar Ibën Bazi dhe Uthejmini – Allahu i mëshiroftë, e kanë zgjedhur mendimin se e prish agjërimin.

20. Mostra e gjakut për analiza: Nuk e prish agjërimin, ngase është pak.

*Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe mëshira e bekimi qofshin për Muhamedin, familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij.*

---

<sup>5</sup> Pastrim i gjakut nga materiet e dëmshme